

VENDIM
Nr. 23, datë 26.9.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 23, datë 26.9.2022, si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje personale nr. 5004 “Blerimi”, në ngarkim të R.Z., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Dibër.

2. Dosje formulare nr. 5075, në ngarkim të M.D., me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë, ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 46 (dyzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula